



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA STIMLJE / MUNICIPALITY OF SHTIME



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komuna Shtime shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i Lartë Ligjor
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	7.5
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	19/12/2022
Afati për aplikim	03/01/2023 - 11/01/2023
Institucioni	Komuna Shtime
Departamenti	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Divizioni	Spektori I Përgjithshëm
Vendi i punës	Komuna e Shtimes
Nr. i Referencës	RN00010640
Kodi	RPC0004310



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të Drejtorisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e objektivave
2. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të drejtorisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohen
3. Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të udhëheqësit jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projekt vendimeve dhe projekt akteve të tjera
4. Bashkëpunon me njësitë tjera brenda institucionit për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit
5. Bën hulumtime dhe analiza që ndërlidhen me aktet normative brenda fushës së përgjegjësisë së drejtorisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e saj
6. Bashkëpunon me zyren ligjore të komunës për përfaqësimin e drejtorisë në konteste gjyqësore dhe koordinon aktivitetet legjislative me drejtoritë tjera në fushën e legjislacionit
7. Kryen edhe detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në Fakultetin Juridik/Drejtësi me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor).
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.



5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 18/01/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- Me datë 25.01.2023, duke filluar nga ora 10: 00 ne sallën e vogël, kati i dytë, objekti i komunes se Shtimes

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

-Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;

-Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;

-Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

-Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;

-Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;

-Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

-Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Data/Datum/Date:	19.12.2022
Nr./Br./No	02/1-183
Për/Za/To:	Shërbyesit civil
Nga/Od/From:	Ardita Ndrecaj, Njësia e Burimeve Njerzore
Lënda/Predmet/Subject :	Njoftim për shpalljen e procedurës së konkursit për lëvizje brenda kategorisë, pozita: Zyrtar i lartë ligjor - Komuna e Shtimes

Bazuar në nenin 38, paragrafi 3, i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë Njësia e Burimeve Njerzore bënë këtë:

NJOFTIM
(për shpalljen e konkursit)

Ju njoftojmë se është bërë shpallja e Konkursit për Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën me të dhënat si në vijim:

Pozita: **Zyrtar i lartë ligjor**

Koeficienti: **7.5**

Klasa e pozitës: **Profesional 1**

Vendi i punës: **Drejtoria për Administratë të Përgjithshme**

Nr. i kërkuar: **1**

Për informata shtesë referojuni Konkursit të datës 19.12.2022 për pozitën **Zyrtar i lartë ligjor** me numër të Referencës RN00010640 i shpallur në linkun <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në webfaqe të Komunës së Shtimes.

Nëse keni paqartësi mund të drejtoheni në Zyren e Personelit në Komunën e Shtimes.

Adresa: Rr. Tahir Sinani, nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>